



V E N D I M
K.P.P. 797/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.11.2018 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e BOE “AVE Consulting” sh.p.k. “Archispace” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Shërbim Konsulence*”, me objekt, “*Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrotullimi Shqiponja Loti 1*”, me nr. REF-86046-09-17-2018, me fond limit 15,376,365.01 lekë (pa TVSH), zhvilluar faza I në datën 28.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Ankimues: Operatori ekonomik “Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k.
Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, Nd. Bjorn, K. 11, 1019, Tiranë.

Autoriteti kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar
Adresa: Rr. “Sami Frashëri”, Nr.33, Tiranë.

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V ë r e n:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 18.09.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “*Shërbim Konsulence*”, me objekt, “*Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrotullimi Shqiponja Loti 1*”, me nr. REF-86046-09-17-2018, me fond limit 15,376,365.01 lekë (pa TVSH), zhvilluar faza I në datën 28.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

II.2 Në datën 28.09.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar fazën e parë të procedurës së prokurimit.

II.3. Në datën 08.10.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "Illyrian Consulting Engineers" & "B-Vaal Engineers" shpk	Kualifikuar;
2. "Geosat Group" & "Instituti i Konsulencës në Ndërtim" shpk	Kualifikuar;
3. "AVE Consulting" & "Archispace" shpk,	Kualifikuar;
4. "A & E Engineering" shpk	Kualifikuar;
5. "Taulant" shpk	Kualifikuar;
6. "47 EK 79" & "Iliriada" pks	Kualifikuar;
7. "CEC Group" shpk	Kualifikuar;
8. "Nord-Comat" shpk	Skualifikuar;

II.4.Në datën 15.10.2018 operatori ekonomik ankimues "Illyrian Consulting Engineers" sh.p.k., ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e këtij të fundit për kualifikimin e BOE "AVE Consulting" sh.p.k. "Archispace" sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5.Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 9004/1 Prot. datë 19.10.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje lidhur me ankesën operatorit ekonomik ankimues "Illyrian Consulting Engineers" sh.p.k., duke mos e pranuar atë.

II.6.Në datën 25.10.2018 operatori ekonomik ankimues "Illyrian Consulting Engineers" sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

"[...]Në përgjigjen e publikuar në internet ne faqen e Agjencisë së Prokurimit Publik, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pasi ka shqyrtuar shprehjet e interesit të paraqitur më datë 28.09.2018 nga Operatorët Ekonomik ka pranuar disa shprehje interesi duke i kualifikuar për fazën e dytë. Në listën e Operatoreve Ekonomik të cilët kanë kaluar në fazën e listës së shkurtër është renditur edhe kompania "A V E Consulting" e cila ka në mënyrë të drejtpërdrejtë konflikt interesi me procedurën e tenderit pasi rezulton të jetë hartuesja e projekt zbatimit për projektin "Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti , Loti 2, Loti 3". Operatori Ekonomik, Illyrian Consulting Engineers Sh.p.k, më datë 15.10.2018 ka ndjekur procedurat e ankimit duke depozituar me shkrim ankesën për procedurën e prokurimit për tenderin me objekt "Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 1". Autoriteti Kontraktor ka dërguar kthim përgjigje me datën 19.10.2018 me anë të postës elektronike në adresën tonë zyrtare dhe një ditë më vonë me Postën Shqiptare, duke refuzuar ankimin tonë. Ankesa në autoritetin kontraktor parashikon se: Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, që bie në kundërshtim me LPP, mund ta kundërshtojë këtë vendim. Illyrian Consulting Engineers Sh.p.k legjitimohet dhe kundërshton vlerësimin e bërë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave duke e konsideruar

atë si të pa bazuar në ligj. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në përgjigjen e tij ka gabuar duke refuzuar ankimin tonë pasi bazuar në VKM me nr. 914 datë 29.12.2014 e ndryshuar, neni 37 pika 3, nën-pika b thotë: 3. Autoriteti kontraktor, përveç kriterëve të përcaktuara në LPP, për skualifikimin e kandidatëve ose të ofertuesve duhet të vlerësojë edhe mbi kushtet e konfliktit të interesit, si vijon: b) Konfliktin ndërmjet veprimtarive të konsulencës dhe prokurimit të mallrave, punëve ose shërbimeve. Në këtë rast, operatori ekonomik i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për mallra, punë ose shërbime për një projekt dhe secili prej anëtarëve të tij duhet të skualifikohet nga ofrimi i shërbimeve të konsulencës që lidhen me këto mallra, punë ose shërbime. Nga ana tjetër, konsulenti i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për përgatitjen ose zbatimin e një projekti dhe secili prej anëtarëve të tij duhet të skualifikohet nga furnizimi i mallrave, kryerja e punëve ose shërbimeve (me përjashtim të shërbimeve të konsulencës) që rrjedhin ose janë të lidhura drejtpërdrejt me shërbimet e konsulencës për këte përgatitje ose zbatim. [...]”

II.7.Në datën 01.11.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.9466/1prot., datë 30.10.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimues,

Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k., mbi kualifikimin e ofertës të BOE “AVE Consulting” sh.p.k. “Archispace” sh.p.k., në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me argumentin: [...]Në listën e Operatoreve Ekonomik të cilët kanë kaluar në fazën e listës së shkurtër është renditur edhe kompania “A V E Consulting” e cila ka në mënyrë të drejtpërdrejtë konflikt interesi me procedurën e tenderit pasi rezulton të jetë hartuesja e projekt zbatimit për projektin “Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti , Loti 2, Loti 3” [...]”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

III.1.2.Në nenin 37, pika 1, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet:

“Shërbim konsulence është një procedurë prokurimi me faza, sipas nenit 34/1 të LPP, e cila shërben për prokurimin e kontratave publike për shërbime të një natyre intelektuale dhe/ose këshilluese”.

Ndërsa në pikën 3 të po këtij neni përcaktohet:

3.Autoriteti kontraktor, përveç kriterëve të përcaktuara në LPP, për skualifikimin e kandidatëve ose të ofertuesve duhet të vlerësojë edhe mbi kushtet e konfliktit të interesit, si vijon: a) *“Konfliktin ndërmjet konsulentëve. Konsulentët nuk mund të ofertojnë me të njëjtën përbërje të stafit. Për këtë qëllim, anëtarët e stafit të një konsulenti duhet të vetëdeklarojnë disponueshmërinë e tyre për konsulentin dhe mosangazhimin në konsulentë të tjerë ofertues në të njëjtën procedurë.*

b) *Konfliktin ndërmjet veprimtarive të konsulencës dhe prokurimit të mallrave, punëve ose shërbimeve. Në këtë rast, operatori ekonomik i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për mallra, punë ose shërbime për një projekt dhe secili prej anëtarëve të tij duhet të skualifikohet nga ofrimi i shërbimeve të konsulencës që lidhen me këto mallra, punë ose shërbime. Nga ana tjetër, konsulenti i kontraktuar nga autoriteti kontraktor për përgatitjen ose zbatimin e një projekti dhe secili prej anëtarëve të tij duhet të skualifikohen nga furnizimi i mallrave, kryerja e punëve ose shërbimeve (me përjashtim të shërbimeve të konsulencës) që rrjedhin ose janë të lidhura drejtpërdrejt me shërbimet e konsulencës për këtë përgatitje ose zbatim.*

c) *Konfliktin ndërmjet detyrave të konsulencës. As konsulentët dhe as ndonjëri prej anëtarëve të stafit të tyre nuk duhet të punësohen për kryerjen e ndonjë detyre që për nga natyra e saj mund të jetë në konflikt me një detyrë tjetër të konsulentëve.*

ç) *Marrëdhënien me stafin e autoritetit kontraktor: konsulentët (përfshirë stafin e tyre dhe nënkonsulentët) nuk duhet të kenë marrëdhënie biznesi ose familjare me një anëtar të stafit të autoritetit kontraktor, drejtpërdrejt ose jo, i përfshirë në ndonjë pjesë të përgatitjes së kushteve të kontratës dhe/ose në procesin e përzgjedhjes për këtë kontratë dhe/ose për mbikëqyrjen e kësaj kontrate”*

III.1.3.Nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, KPP konstaton se, operatori ekonomik “AVE Consulting” sh.p.k., ka hartuar projekt-zbatimin e objektit “Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrotullimi Shqiponja Loti 1, Loti 2, Loti 3”. Gjithashtu, Komisioni konstaton se ky operator ekonomik, është pjesëtar i bashkimit të operatorëve ekonomik “AVE Consulting” sh.p.k. “Archispace” sh.p.k., të cilët kanë paraqitur ofertë për procedurën objekt shqyrtimi, procedurë e cila kryhet nga autoriteti kontraktor për prokurimin e shërbimit të mbikëqyrjes (supervizionit) të

punimeve që do të kryhen për zbatimin e projektit të hartuar nga operatori ekonomik “AVE Consulting” sh.p.k.

III.1.4. Nga interpretimi literal i përcaktimeve të nenit 37, pika 1, gërma b, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Komisioni gjykon se, janë përcaktuar qartë rastet e konfliktit të interesit, si dhe kufizimet e konsulentit i cili është kontraktuar nga autoriteti kontraktor për përgatitjen e projekt – zbatimit. Këto raste konsistojnë vetëm në furnizimin e mallrave, kryerjen e punëve apo shërbimeve për zbatimin e projektit të hartuar nga konsulenti. Nga ana tjetër, në këtë dispozitë, është përcaktuar një rast përjashtimor në të cilin konsulenti që ka përgatitur projektin nuk konsiderohet në kushtet e konfliktit të interesit. Rasti përjashtimor vlen për shërbimet e tjera të konsulencës që rrjedhin ose janë të lidhura me zbatimin e projektit të hartuar nga konsulenti. Në rastin konkret, procedura e prokurimit objekt shqyrtimi, ka për objekt kontrate prokurimin e shërbimit për mbikqyrjen (supervizionin) e punimeve të zbatimit, shërbim i cili është i natyrës intelektuale dhe përfshihet plotësisht në rastin përjashtimor të parashikuar në nenin 37, pika 1, gërma b, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, pasi kemi të bëjmë me shërbim konsulence. Në këto kushte, Komisioni gjykon se, përsa kohë operatori ekonomik “AVE Consulting” sh.p.k., i cili ka përgatitur projektin, nuk konsiderohet në kushtet e konfliktit të interesit për pjesëmarrjen në procedurën e prokurimit për mbikqyrjen e zbatimit të punimeve të projektit të hartuar prej tij, atëherë ky operator ekonomik mund të marrë pjesë lirisht si ofertues në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Illyrian Consulting Engineers” sh.p.k. për procedurën e prokurimit, “*Shërbim Konsulence*”, me objekt, “*Supervizion Punimesh, Rehabilitim i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta - rrethrotullimi Shqiponja Loti 1*”, me nr. REF-86046-09-17-2018, me fond limit 15,376,365.01 lekë (pa TVSH), zhvilluar faza I në datën 28.09.2018, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.

3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1638 protokoli Datë 25.10.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha